

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 4.5.2021, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.1.2021”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83 , datë 1.6.2021, bëhen korrigjimet e gabimeve si më poshtë:

- Titulli i vendimit bëhet:

- “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë **25.2.2021**”.

- Paragrafi i parë i vendimit bëhet:

“Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019; të neneve 15, pika 1, dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 3.5.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021.”